
PERSONAL FINANCES - CONTEMPORARY CHALLENGE

Burim Morina

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, bmorina7@hotmail.com

Ylber Krasniqi

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, ykrasniqi@hotmail.com

Mustafë Kadriaj

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, mustafkadriaj@live.com

Abstract: The purpose of this paper is financial education and personal finance management, which is a very important component because a financially educated individual increases the opportunity for personal finance growth and as such contributes to the performance of a country's economy. Today, the reality in Kosovo shows that Albanians lack information about this field, due to the economic and political transition that our country has gone through. Another reason is the lack of information in high school curricula. Young people are the future of the country and as such they need to be educated financially, so the government must create opportunities for them and support programs. Together with the systems of good governance, democracy and the rule of law, it is the human and social dimensions of Kosovo that underlie economic growth. Good financial planning and maintaining financial stability will help prevent financial crises, which are associated with irreparable social consequences such as divorce and other consequences that distort the normal continuity of a healthy family or an unconditional individual personality.

This paper is dedicated to the general public, in order to simply approach the basic concepts and notions from the field of personal financial management. During the preparation of this paper, efforts have been made to be understandable for both the younger generations and people who do not have formal economic education, so that through this paper the public is informed what is the most appropriate way to manage financial resources that to achieve the desired goals. More specifically, the paper provides an explanation of how money can be managed wisely, how to prepare financial plans and monitor their implementation, how to be careful and not to be overburdened with financial debts, how to use funds carefully taken with credit and credit cards and regularly pay off debts etc.

Keywords: Personal finance, management, challenges, contemporary

FINANCAT PERSONALE SFIDË BASHKËKOHORE

Burim Morina

Kolegji "Biznesi" Prishtinë – Kosovë, bmorina7@hotmail.com

Ylber Krasniqi

Kolegji "Biznesi" Prishtinë – Kosovë, ykrasniqi@hotmail.com

Mustafë Kadriaj

Kolegji "Biznesi" Prishtinë – Kosovë, mustafkadriaj@live.com

Abstrakt: Qëllimi i punimit është edukimi financiar dhe menaxhimi i financave personale, e cili është një komponent shumë e rëndësishme sepse një individ i edukuar financiarisht rrit mundësinë për rritjen e financave personale dhe si i tillë kontribuon në performacën e ekonomisë së një vendi. Sot realiteti në Kosovë tregon se shqiptarët kanë mungesë informacioni në lidhje me këtë fushë, kjo për arsye të tranzicionit ekonomik politik që ka kaluar vendi ynë. Arsye tjetër është mungesa e informacionit në kurrikulat e shkollave të mesme. Të rinjtë janë e ardhmja e vendit dhe si të tillë ato duhen edukuar financiarisht, pra qeveria duhet të krijojë mundësi për to dhe programe mbështetëse. Së bashku me sistemet e mirëqeverisjes, demokracisë dhe shtetit ligjor janë dimensionet njerëzore dhe sociale të Kosovës ato që qëndrojnë në themel të rritjes ekonomike. Një planifikim i mirë financiar dhe një ruajtje e stabilitetit financiar do të ndihmojë për të parandaluar kriza financiare, të cilat shoqërohen me pasoja të pakorrigjueshme sociale si p.sh., divorcet dhe pasoja të tjera që deformojnë vijueshmërinë normale të një familje të shëndetshme apo të një personaliteti individual të pakushtëzuar.

Ky punim i dedikohet publikut të gjerë, me qëllim që në mënyrë të thjeshtë t'ia afrojë konceptet dhe nocionet themelore nga fusha e menaxhimit të financave personale. Gjatë përgatitjes së këtij punimi janë bërë përpjekje që të jetë e kuptueshme edhe për brezat e rinj edhe për personat që nuk kanë arsim formal ekonomik, në mënyrë që nëpërmjet këtij punimi publiku të informohet se cila është mënyra më e duhur për menaxhimin e mjeteve financiare

që të arrihen qëllimet e dëshiruara. Më konkretisht, punimi sjell shpjegim për atë se si mund të menaxhohen paratë me mençuri, si të përgatiten plane financiare dhe të monitorohet realizimi i tyre, si të bëheni të kujdesshëm dhe të mos stërnqarkoheni me borxhe financiare, si t'i shfrytëzoni me kujdes fondet e marra me kredi dhe kartelat kreditore dhe rregullisht të shlyeni detyrimet etj.

Fjalët kyqe: Financat personale, menaxhimi, sfida, bashkëkohore

1. DEFINIMI I FINANCAVE PERSONALE

Qenia njerëzore është burimi më i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm. Ai është qenie që e ka vetëdijen, është kureshtar me interesim të shprehur për ta njohur rrethinën e tij, ka interesim për të mësuar, ka ide si ti forcojë aftësitë dhe shkathhtësitë e veta, të cilat do ti nevojiten që ta përballojë rrethinën dhe që të mbijetojë në të. Të gjitha këto veqori dhe shumë të tjera janë cilësi vetëm për njeriun si qenie me intelegjencë dhe e aftë për të gjykuar. (Havolli, 2014, p. 5)

Financë - janë fondet në para që përdoren për një qëllim apo veprimtari të caktuar ekonomike. Në një kuptim më të gjerë është sigurimi dhe administrimi i parave, shpenzimeve dhe të ardhurave të një biznesi apo vendit në tërësi. (Skenderi, 2010, p. 78)

Financim - është sigurimi, vënia në gatishmëri dhe përdorimi i kapitalit për qëllime ose veprimtari të caktuara ekonomike. (Skenderi, 2010, p. 79)

Mirëqenia – nënkuptohet një gjendje e nivelit jetësor të popullsisë së një vendi, në të cilën nuk ekzistojnë dukuri të mos plotësimit të nevojave më të domosdoshme materiale e shpirtërore të njerëve, por përkundrazi plotësimi i kërkesave në rritje i këtyre nevojave përmirsimit si nga pikpamja sasiore, ashtu edhe cilësore, si nga pikpamja materiale, ashtu edhe nga pikpamja e kushteve politike, arsimore, shëndetësore, etj. (Skenderi, 2010, p. 157)

Kthimi i investimit- Nëse blini aksione dhe obligacione çfarë kthimesh mund të prisni? Një nga mjetet për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje është të përcaktohen kthimet historike dhe të supozohet se për një periudhë të zgjatur kohe, kthimet historike parashikojnë kthimet e ardhshme. Kështu, në qoftëse kthimi historik i investimeve në aksione të zakonshme është 10 përqind, edhe në kohën e mëpasme investimet në aksione të zakonshme do të vazhdojnë të krijojnë kthimet 10 përqind. (B. Mayo, 2012, p. 324)

Financat personale - kanë ngjallur interesim të madh në publik veqanërisht këto dekadat e fundit. Ka mjaft persona, apo familje që zotrojnë pasuri të mëdha në statusin e individit, në statusin personal. Këtu përfshihen shumë kategori profesionale si: futbollistë, artistë, kineastë, biznesmenë, kirurgë, avokatë, dhe profesione të tjera. Ata theksisht janë më të suksesshëm dhe sigurojnë të ardhura të mëdha nga ushtrimi i profesionit, por ata dallojnë njëkohësisht edhe për mënyrën me racionale të administrimit të situatës financiare të familjes së tyre. Koncepti mbi financat personale lidhet me administrimin e pasurisë në familje, me vendimarrjet racionale për përdorimin e flukseve të të ardhurave familjare, madje jo vetëm të familjeve të pasura, por edhe më gjerë, me administrimin e pasurisë të të gjitha familjet pa përjashtim. (Bundo, 2012, p. 337)

2. NJOHURI MBI FINANCAT PERSONALE

Etika në financat personale -Kur planifikimi i financave personale bëhet profesion më vete, atëher ai ushtrohet dhe duhet të ushtrohet nga njerëz të kualifikuar. Eksperit i financave familjare hyn në botën intime të klientit të vet njëllor si avokati apo mjeku me klientët e tyre. Ndërtimi i një profesioni mbi këto raporte kërkon që të ekzistojnë, të vendosen dhe të respektohen disa rregulla bazë etike. Duhet të sillen ndershëmrish, të zbatohen ligjin, të veprojnë në interes të klienteve të tyre dhe t'i binden rregullave të caktuara si profesionistë. (Bundo, 2012, pp. 366,367)

Në jetën e përditshme individuale apo në familje njerëzit ballafaqohen në çdo hap me vendimarrje të rëndësishme, të cilat nëse nuk merren në mënyrën dhe kohën e duhur japin efekte me pasoja jashtzakonisht të dëmshme. Ndërkohë duhen nënvizuar disa nga vendimarrjet më delikate në botën financiare personale, të cilat në asnjë rrethanë nuk mund të konfirmohen pa një minimum njohurish nga kjo fushë. Duhet njohur financat personale për ta jetuar me dinjitet jetën dhe menaxhuar drejt mundin, djersën dhe sakrificat familjare aktuale dhe të trashëguara. Llogaritja e kapacitetit të kursimit është çështje e lidhur me gjetjen e pikes së ekuilibrit midis të ardhurave dhe shpenzimeve në familje.

Kur duhet investuar?

A duhet marrë përsipër individualisht risku i investimit?

Sa tatime duhet të paguaj një familje?

Cili është kapaciteti huamarrës për një familje?

Sa duhet të paguajë një familje si prim për të siguruar jetën, shëndetin, dhe pasurinë për të gjithë pjestarët e saj. Më mirë të investosh dhe të blesh një banesë apo të marrësh me qira një banesë. (Bundo, 2012, pp. 338,339)

Modeli i thjeshtë i planifikimit financiar të familjes - Paraja mund të mos bëjë të lumtur, por mungesa e plotë e saj sjell shumë paknaqësi dhe një jetë plotë stres. Shoqëria njerëzore e përdor parën si mjet shkëmbimi, si

instrument komunikimi me botën, prandaj duhet të mësohmi ta menaxhojmë atë sa më mirë që të jetë e mundur nëse dëshirojmë t'i japim vlera vetë jetës, punës dhe pasurisë.

Planifikimi financiar nënkupton një seri vendimesh lidhur me sasinë e parave që i duhen familjes për një periudhë të caktuar, në të ardhmen, për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj, si dhe mënyrën apo burimet e sigurimit e tyre.

Qëllimet duhet të shprehen në trjatë monetare dhe duhet t'i referohen një periudhe kohe të përcaktuar, në mënyrë që të parashikohen. Për të arritur qëllimet, familja mund të përdor dy burime: ajo harxhon një sasi parash nga të ardhurat korente nga puna, por mund të përdorë edhe pjesë të të ardhurave që siguron nga investimet e bëra më parë. (Bundo, 2012, p. 340)

Objektivat e financave personale -Dega e re e shkencës së finances, financat personale, synon që të arrihen disa objektiva të cilat shprehin gjithë pëmbajtjen finaciare të familjes. Këto objektiva mund të shprehen në tre drejtime kryesore:

Së pari, financat personale synojnë të ndërtojnë një bilanc familjar, që përfshin: burimet financiare të familjes, detyrimet dhe huatë e saj, si dhe vlerën që zotëron familja në terma financiare.

Së dyti, familja ka nevojë gjithashtu që të përgatisë një buxhet për periudhën e ardhëshme të kohës, buxhet ky që është i pashkëputur nga synimet familjare.

Më në fund, financat personale synojnë të vendosin mekanizmat e nevojshëm të kontrollit në mënyrë që familja të realizojë buxhetin e synuar dhe të vazhdojë drejt arritjes së qëllimeve të saj. (Bundo, 2012, pp. 341,342)

Dallimet thelbësore midis financave të familjes dhe të biznesit -Disa nga shpjegimet që bëhen mbi financat personale janë të ngjashme me kontabilitetin financiar që përdor biznesi. Ngjajshmëria midis tyre është e dukshme. Planifikimi dhe kontrolli i financave personale synon mbarvajtjen financiare të familjes. Financat personale janë më të thjeshta se sa ato të bizneseve. Midis financave personale dhe atyre të biznesit ka disa dallime, ndërmejt të cilave si më të rëndësishme konsiderohen:

Së pari, financat personale paraqesin interes vetëm për pjestarët e familjes.

Së dyti, në bilancet apo financat personal, ka disa zëra, disa mjete, për të cilat objektivi që synohet është i ndryshëm nga ai shtrohet në financat e bizneseve. P.sh. Nëse aksionet e një biznesi rriten në vlerë, vlera regjistrohet si pjesë e së ardhurës dhe në të njëjtën kohë rritet fitimi i mbajtur dhe vlera e aksionit në bilanc. Nëse vlera e shtëpisë rritet, rritja mundet të regjistrohet në bilancin familjar dhe në vlerën pasurore neto, por nuk mund të merrmi me regjistrimin e kësaj si një e ardhur.

Së treti, paga apo të ardhurat e tjera të familjes nuk shihen si kthim i një të vetëm apo i një kompleksi investimesh, ose aktivesh. Niveli i pagës gjykohejt si justifikim i investimit të shkollimit por jo si kthim i tij. (Bundo, 2012, pp. 342,343)

Bilanci për pasurinë e familjes -Bilanci familjar, që mundet të quhet edhe raporti i vlerës pasurore neto të familjes, është një lloj fotografie që paraqet gjendjen financiare të familjes në një moment të caktuar. Në përbërjen e tij përfshihen aktivitet dhe pasivitet, ndërsa informacioni bazë që "prodhohejt" prej bilancit është vlera neto. Familja ka nevojë të harotojë një bilanc familjar për dy arsye kryesore:

Së pari, sepse ka nevojë për një document bazë me të cilin të gjykojë se si janë plotësuar qëllimet financiare të familjes.

Së dyti, përmes radhitjes dhe vlerësimit të aktiveve të bilancit familjar qartësohejt s eku dueht të përqëndrohejt menaxhimi financiar nga çdo familje. (Bundo, 2012, p. 343)

Koncepti i kapitalit njerëzor - Kapitali njerëzor, në terma financiarë, është aftësia që zotëron individi për të siguruar të ardhura nga puna. Kështu, për shembull, një mjek zotëron më tepër kapital njerëzor se sa një marangoz sepse ai ka shpenzuar shumë vite për të mësuar dhe përvetësuar disa aftësi dhe cilësi profesionale të vështira, prandaj edhe shoqëria e shpërblen atë më shumë se sa marangozin. Ndonëse kapitali njerëzor është shumë i vlefshëm, ai nuk pasqyrohejt në bilanc.

Individi që ka zgjedhur profesionin e marangozit, e rrit në mënyrë progressive pagën e tij, krahas zgjerimit të njohurive në profesionin e tij. Niveli i pagës së marangozit arrin pikun në më pak se dhjetë vjet dhe pas këtij momenti të ardhurat e tij rriten në terma realë vetëm në sajë të inflacionit dhe punës jashtë orarit. Individi tjetër, studion për gjatë shumë viteve që të diplomohet si mjek. Në moshën 28 vjeqare, ai nis të sigurojë përfitime të arsyeshme. Në moshën 35 vjeqare kjo e ardhur kap një nivel të lartë vjetor. (Bundo, 2012, pp. 349,350)

Raporti i të ardhurave familjare-Bilanci familjar paraqet pozitën financiare të familjes sot. Nderkaq, raporti i të ardhurave paraqet sesi është arritur në pozicionin e sotëm financiar të familjes duke u nisur nga gjendja e vitit të kaluar. Raporti i të ardhurave është i nevojshëm që të kuptojmë sesi kemi përparuar në drejtim të arritjes së qëllimeve tona. Ky raport hedh themelet për buxhetin, që është plani I vitit në vijim. Raporti emërtohejt I të ardhurave. Ky është termi i përdorur gjerësisht, ka kuptimin e pasqyrës së lëvisjeve të likuiditeteve, pasi financat personale nuk merren shumëme kontabilitetin rrjedhës.

Në raport regjistrohen të ardhurat dhe shpenzimet në momentin kur ato ndodhin realisht dhe jo në çastin kur merret vendimi që të kryehet këto transaksione. (Bundo, 2012, p. 350)

Tabela. 1. Raporti i të ardhurave personale

Të gjitha burimet e të ardhurave neto pas ndalesave
Taksa të papaguara në burim,
Rimbursime (përfitime) nga taksat,
Të ardhurat neto,
Shpenzimet,
Fitimi neto,
Shpenzime jo të lira,
Rrjedha e lire likuide,
Shpenzime të lira,
Rrjedha likuide neto,

Burimi: (Bundo, 2012, p. 351)

Të ardhurat dhe humbjet kapitale - Nëse para dhejtë vitesh keni blerë një shtëpi për 80 000 euro dhe e shisni sot për çmimin 120 000 euro, kjo do të thotë se keni realizuar një të ardhur nga rritja e vlerës së pasurisë capital. Diferenca prej 40 000 euro është objekt I tatimit, që quhet tatimi mbi të ardhurat nga tjetërsimi I pasurisë së palaujtshme dhe tatohet me shkollën tatimore 10%. Një humbje kapitale ndodh atëherë kur çmimi I shitjes është më I ulët se çmimi I blerjes dhe kosotoja e transaksionit, të marrë së bashku. (Bundo, 2012, p. 359)

Vlera e një shtëpie- Për shumë njerëz dhe për shumë familje, blerja e shtëpisë është investimi më I madh në jetë. Deri kohët e fundit, në Europë, njerëzit mendonin se shtëpitë janë investimi më I mirë që mund të bëhet. Vërtetë, pasuritë e patundshme kanë qenë një investim I mirë gjatë shpërthimit të viteve shtatëdhjetë dhe në fillim të viteve tetëdhjetë kur çmimi I shtëpive u ngrit në qiell në shumë pjesë të Europës dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sidomos në qytete të mëdha si Parisi, Roma, Londër, Madrid, Berlin etj. Në vitet e arta të tregut të pasurive të patundshme, shumë mendonin se ai që nuk zotëronte një shtëpi ishte i njorant nga pikpamja financiare.

Vlerësimi I një shtëpisë – Vlera e tregut të një shtëpie duhet llogaritur, dhe procesi i llogaritjes të kësaj vlere quhet vlersim.

Vlera e tregut - të një shtëpie përcaktohet si çmimi më i lartë që një blerës do të paguante nëse shtëpia ofrohet në shitje, në treg të hapur, duke lejuar një kohë të arsyeshme për të gjetur një blerës që kërkonin të blejë dhe ndërkohë, as blerësi, as shitësi nuk veprojnë në rrethana nevojë, detyrimi ose privilegjimi.

Përafrimet në vlerësime – ka dy metoda të përgjithshme për të vlerësuar një shtëpi: Metoda e drejtpërdrejtë krahasuese tregtare dhe metoda me kosto. (Bundo, 2012, pp. 362,363,364)

Më mirë të investosh apo të marrësh me qira? - Është një pyetje që I bëjnë vetes pothuaj të gjithë qytetarët në rrethana të ndrsyhme. Në kohën e sotme, në vendin tonë, vërehet prirja e investimeve të popullsisë, të familjeve, në blerje të banesave. Këtu ndikon edhe përballimi i normës së inflacionit, shpesh herë në nivele të larta, i cili në mënyrë të padukshme, por në mënyrë shumë të ndejshme zhvlehtëson kursimet e familjeve.

Ndërkohë nevoja për shtëpi mund të zgjidhet edhe përmes qirasë. Edhe qiraja duhet paguar, madje çdo muaj. Ju është dhënë mundësia të merrni me qira një apartament për 12000 euro nëvit. Ndërkohë jeni duke diskutuar edhe mundësinë e blerjes së kësaj shtëpie që ndodhet në një nga lagjet më të mira të kryeqytetit, për 200 000 euro. Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve të shtëpisë janë në ngarkim të pronarit të saj dhe shkojnë 1000 euro çdo vit. Këto shpenzime, kur bëhen nga ju janë të zbritëshme në qiranë që ju I paguani pronarit të shtëpisë. Niveli I tatimeve mbi të ardhurat që ju duhet të paguani pronarit të shtëpisë. Niveli itatimeve mbi të ardhurat që ju duhet të paguani është 30%. Nga ana tjetër, pronari pagaun një taksëpër shtëpinë e dhënë me qira për 800euro në vit.

Objektivi juaj është që të garantoni një strehim me vlerë aktuale të shpenzimeve, që duhet të paguani për këtë, sa më të ulët të mundshme. Në këto rrethana sigurisht që jeni në dilemën: të blini apartamentin apo të vazhdoni të jetoni me qira në të? (Bundo, 2012, pp. 364,365,366)

3. ANALIZA E INVESTIMEVE TË FINANCEVE PERSONALE

Hapat që duhet të ndiqni për të menaxhuar financat tuaja personale - Do të ishte mirë nëse do të kishit një formulë magjike apo një hile të lehtë e cila do t'ju hiqte shqetësimet për të ardhurat tuaja. Nëse jeni të stresuar rreth parave tuaja gjatë gjithë kohës, atëherë duhet ti hedhësh një vështrim financave personale. Ka 5 çelësa që ju ndihmojnë të mbani kontrollin e financave tuaja. Nëse i ndiqni rregullisht këto 5 hapa, atëherë mund ti sheshoni shqetësimet vetes suaj. Kjo sepse ju tashmë mund të keni një plan të qartë që mund të ndiqni.

1. Fillo me objektivat- Gjëja e parë që duhet të bësh është të shkruash qartë dhe sa më specifike objektivat, qëllimet në lidhje me atë çfarë ju doni të bëni me jetën apo paratë tuaja. Financat mund t'ju prekin në shumë fusha të jetës. Objektivi juaj për të shëtitur botën do të ndikojë në planin financiar tuajin. Blerja e një shtëpie, fillimi i një familje, ndryshimi i një karriere, do të ndikojnë në mënyrën sesi do të menaxhoni financat. Pasi ti keni shkruajtur objektivat tuaj, do t'ju duhet ti rendisni sipas rëndësisë. Kjo bën që ju të fokusoheni sipas rëndësisë në gjërat më të rëndësishme për ju. Ju mund ti rendisni dhe sipas realizimit të tyre, por gjithmonë duhet të punoni dhe me objektivat e tjera paralelisht, psh me objektivin afatgjatë, kursimi i parave për moshën e pensionit.

- Fillo duke vendosur objektivat afat gjatë, si psh shlyerja e borxheve, blerja e një shtëpie, apo dalja në pension herët. Këto objektiva do t'ju ndihmojnë të fokusoni në objektivat afat shkurtra.
- Rendisni sipas rëndësisë objektivat në mënyrë që të krijoni planin tuaj (cili është hapi i radhës).
- Vendosni objektivat afatshkurtra, si plotësimi i një buxheti, ulja e shpenzimeve, apo ndalimi i përdorimit të kartës së kreditit.

2. Krijoni një plan - Një plan do ju ndihmojë të arrini qëllimet tuaja. Një plan duhet të ketë disa hapa. Pjesa e parë e planit tuaj duhet të ketë të bëjë me kontrollin e buxhetit tuaj. Ju duhet të krijoni një plan shpenzimi. Pjesa e dytë e planit duhet të ketë të bëjë me shlyerjen e borxheve. Pasi ti keni përmbushur këto dy gjëra, ju duhet të vendosni se çfarë duhet të bëni me paratë tuaja për të arritur objektivat. Paratë që do ju çlirojnë nga borxhet mund të përdoren për të arritur objektivat tuaja. Pas këtij momenti ju duhet të vendosni se cilat prioritete janë më të rëndësishme për ju në këto momente, ndërkohë që punoni paralelisht me objektivat afatgjatë, duhet të fokusoheni në gjërat më të rëndësishme që keni vendosur për veten tuaj. Objektivat tuaja, sëbashku me një fond emergjence, do ju ndihmojnë të merrni vendime bazuar në frikë dhe do ju ndihmojnë të merrni kontrollin mbi situatën tuaj.

- Buxheti është suksesi juaj. Është vegla që do ju jap kontroll mbi financat tuaja në të ardhmen. Buxheti juaj mund t'ju ndihmojë të arrini pjesën tjetër të planit.
- Përdorni një program buxhetime apo shpenzimesh, në mënyrë që të keni një pikënisje për buxhetin tuaj.
- Merrni kohë të fokusoheni mbi buxhetin tuaj. Nëse keni nevojë për ndihmë, konsideroni një ndihmë nga ndonjë ekspert financiar.

3. Qepuni objektivat - Buxheti juaj është një nga veglat më të mëdha të cilat ju ndihmojnë t'ia dilni financiarisht. Ju lejon të krijoni një plan shpenzimi në mënyrë që të mund të fokusoni paratë tuaja në një mënyrë që plotëson objektivat tuaja. Edhe pasi të keni shlyer detyrimet, ju duhet të krijoni një buxhet. Është më e lehtë të shpenzoni se sa të bëni, dhe nëse nuk arrini të ndaloni, ju mund të zhyteni sërish në borxh. Një buxhet ju lejon të vendosni se sa mund të shpenzoni. Pa një plan, ju mund ti harxhoni paratë në gjërat që nuk kanë rëndësi për ju, por që në një moment mund të pyesni veten se çfarë ke bërë me objektivat financiare që vendosët vetë. Nëse jeni i martuar dhe gruaja juaj mund të ndihmojë të punoni sëbashku mbi buxhetin. Kjo do ju ndihmojë të arrini objektivat tuaja dhe të parandaloni së luftuari.

- Konsideroni të krijoni një sistem buxhetime që përdor para kesh për kategoritë e vështira
- Gjeni një aplikacion për buxhetimin e parave, ku për çdo shpenzim të keni parasysh buxhetin që duhet të arrini.
- Planifikoni në kohë që të parandaloni mbi shpenzimet, e cila është suksesi i të qenit financiarisht i suksesshëm.

4. Çlirohuni nga borxhet - Borxhet janë një pengesë e madhe në realizimin e objektivave tuaj. Duke vendosur një plan eliminimi ju do të mund të ecni përpara me fokusimin e krijimit të buxhetit tuaj. Shpenzoni pak dhe hiqni një pjesë të borxhit që keni, pastaj pjesën tjetër, derisa të çliroheni nga ky borxh. Mos mbani kartë krediti me vete, dhe krijoni një plan emergjence me vete që të mund të rikuperoni shpenzimet e papritura, kështu që do të mund të jeni të lirë nga përdorimi i kartës së kreditit, apo kreditit.

- Ju mund të shisni objektet apo sendet që të rikuperoni para.
- Ju mund të filloni një punë të dytë me orë të limituara.
- Ju mund të shikoni të shkurtoni shpenzimet në mënyrë që të rrisni buxhetin.

5. Mos keni frikë të kërkoni për këshilla - Pasi të jeni gati për të rritur pasurinë tuaj dhe për të filluar të investoni duhet të flisni me një projektues financiar për t'ju ndihmuar në marrjen e vendimeve tuaja të investimeve. Një këshilltar i mirë do të ndajë rreziqet në çdo investim, për t'ju ndihmuar sadopak të gjeni produkte të cilat përputhen me nivelin tuaj duke ndihmuar që të punoni drejt në qëllimet tuaja sa më shpejt të jetë e mundur. Një planifikues financiar mund t'ju ndihmojë me buxhetin tuaj. Mos harroni se investimi është një strategji afatgjatë për ndërtimin e pasurisë. Një kishë apo komunitet mund të ofrojë klasa për financat personale dhe buxhetimin. Ju gjithashtu mund të gjeni një mësues që do të jetë i gatshëm të ecni nëpërmjet buxhetit tuaj muajt e parë. Kjo

mund t'ju ndihmojë nëse ju jeni të tronditur me buxhetin tuaj. Një këshillues mund të ndihmojë me zonat e tjera financiare si hapjen e një biznesi apo diçka të ngjashme. (<http://www.scan-tv.com/hapat-qe-duhet-te-ndiqni-per-te-menaxhuar-financat-tuaja-personale/>, n.d.)

Ç'duhet financat personale - Mënyra më e mirë për ta arritur këtë është nëpërmjet një analize të detajuar të zakoneve të shpenzuarit të përditshëm si dhe krijimi i një buxheti. Një buxhet është praktikisht deklarata juaj e të ardhurave dhe jo vetëm që ju ndihmon të matni dhe të përcaktoni sasinë e shpenzimeve tuaja, por gjithashtu luan një rol thelbësor në kuptimin e financave tuaja.

Hapi I: Mblidhje të gjitha shpenzimet fikse të familjes. Shpenzimet fikse përfshijnë: faturat e dritave, shërbimet komunale, kabllori, fatura e internetit dhe fatura e telefonit.

Hapi II: Mblidhni të gjitha faturat dhe shpenzimet, të cilat mund të jenë: ushqimet, kurset sportive për fëmijët, shpenzime argëtuuese në fundjave, shpenzimet e arsimit dhe pagesat e kartës së kreditit. Përfshini gjithçka që ju keni shpenzuar në muajin e fundit.

Hapi III: Shikoni me vëmendje listën dhe shikoni se cilat shpenzime janë të domosdoshme dhe cilat shpenzime mund të kurseni për muajin e vazhdim.

Hapi IV: Krijoni një buxhet duke shtuar shpenzimet e caktuara në të. Këto shpenzime e nevojshme mund të vendosen nën shpenzimet fikse. Çdo gjë mbi këtë kufi duhet të vendoset si shpenzim fleksibel.

Hapi V: Zbrisni shpenzimet fikse nga të ardhurat e përgjithshme të familjes. Mënjëherë një sasi parash për çdo muaj për të paguar borxhet dhe të hapni një llogari kursimi. Zbrisni borxhin dhe sasinë e kursimeve nga shuma e mbetur.

Hapi VI: Ruani paratë e mbetura për shpenzimet fleksibël. Shpenzimet të paparashikuara mund të keni çdo muaj dhe mund të përfshijnë: riparimin e makinës, shpenzime mjekësore, festa e ditëlindjes, udhëtime emergjente, dhuratat, demot e shtëpisë si dhe pushime në fundjave me familjen. (<http://www.unifin.al/si-te-menaxhoni-buxhetin-familjar/>, n.d.)

Këshilla për menaxhimin e parave - Sa herë iu kanë thënë se kursimi i parave është një gjë e mirë? Specialistët e financave rekomandojnë të kurseni para çdo muaj, por kjo është më e lehtë të thuhet se sa të bëhet. Mirëpo, nëse dëshironi të nisni një kompani, ju do të duhet të largoheni nga ky cikël dhe të filloni të kurseni. Nganjëherë, kjo do të jetë një detyrë testuese, por duhet të bëhet nëse dëshironi të investoni në të ardhmen tuaj si një ndërmarrës. Nëse dëshironi të filloni të menaxhoni paratë tuaja në mënyrë më efektive dhe të përgatisni veten për ndërmarrësi, ndiqni gjashtë këshillat më poshtë. Me këto teknika në arsenalin tuaj, ju do të filloni të shihni ndryshime të menjëhershme dhe do të filloni të keni shprehje të mira të cilat do ju shërbejnë gjatë karrierës tuaj si një ndërmarrës. Bëni prioritet organizimin. Kur jeni të organizuar, ju mund të gjurmoni financat tuaja. Regjistroni të gjitha informacionet financiare në një vend që të gjurmoni progresin tuaj. Kur gjurmoni të gjitha informacionet tuaja financiare, ju mund t'i organizoni ato nga kategoria. P.sh., kur regjistroni shpenzimet tuaja aktuale, ju mund t'i kategorizoni ato si "urgjente" dhe "në të ardhmen". Jo vetëm që ky sistem ju ndihmon të ju qëndroni gati financave personale, por do të ju përgatisë për sukses në ndërmarrësi sepse është një aftësi e transferueshme.

Kurseni ku të mundeni. Njerëzit shpesh hezitojnë kur është fjala të shpenzojnë më pak. Fatmirësisht, ka disa mënyra të lehta për të kursyer. Shikoni shprehjet tuaja ditore dhe shihni nëse keni ndonjë trend të shpenzimeve. P.sh., nëse shpenzoni 5 dollarë çdo ditë në kafe, pijeni atë çdo dy ditë. Ngadalë, ju do të mësoheni më këtë shprehje të re, dhe llogaria juaj bankare do të korrë shpërblimet. Kërkoni informacione shtesë. A keni dëgjuar për The Penny Hoarder ose për Dough Roller? Këto janë blogje të financave personale të cilat mund të ju ndihmojnë të menaxhoni më mirë paratë tuaja, por ka më shumë prej kësaj. Abonohuni në webfaqe dhe ndiqni emisione me audio të cilat ofrojnë këshilla për menaxhimin e parave. Vendosni qëllime afat-shkurtëra dhe afat-gjatë. A keni vënë re ndonjëherë se njerëzit dëshirojnë të arrijnë qëllimet e tyre në një kohë të shkurtër? Nëse kapni çdo revistë të shëndetit, thotë se mund të ju ndihmojë të arrini rezultate ekstreme në një kohë të shkurtër. Fatkeqësisht, këto dijeta nuk janë efektive, dhe teknikat "pasurohu shpejtë" nuk funksionojnë. Është e vështirë t'a pranoni se qëllimet tuaja do të marrin kohë për t'u përbushur, e cila është arsyeja pse ju krijoni qëllime afat-shkurtëra dhe afat-gjatë.

Në çdo rast, synoni të vendosni qëllime specifike, të matshme, të arritshme dhe të bazuara në kohë.

Në mënyrë ideale, arritja e qëllimeve tuaja afat-shkurtëra do ju japë reagime pozitive për të cilat keni nevojë që të vazhdoni të përpiqeni për qëllimet tuaja afat-gjatë.

Gjeni një mentor - Nëse menaxhoni financat personale dhe ndërmarrëse, një gjë është e sigurtë, nganjëherë do të ndiheni sikur nuk mund të përballoni të gjitha. Planifikimi financiar mund të jetë i vështirë. Si një individ, ju mund të kërkoni mentorë të cilët mund të ju ndihmojnë me financa personale. Si ndërmarrës, ju mund të vazhdoni të punoni me këta njerëz ose të kërkoni këshillues financiarë të cilët ju ofrojnë udhëzimet e nevojshme për të drejtuar biznesin tuaj. Menaxhimi i financave tuaja është një përvojë shpërbluese. Do të duket e ngatërruar ndonjëherë, por sa më shumë që e praktikoni, aq më shumë do të përmirësoni financat personale dhe të përgatisni veten për sukses të menaxhimit të parave. (<https://besimtari.com/ja-6-keshilla-per-menaxhimin-e-parave/>, n.d.)

4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Menaxhimi i financave personale është një temë e cila nuk mësohet në shkollë, por është diçka me të cilën të gjithë do të ndeshemi një ditë. Prandaj për t'i menaxhuar më mirë financat dhe për të pasur jetën më të kollajshme, duhet t'i ndiqni katër hapa.

Krijoni një buxhet - Për një muaj gjurmojini shpenzimet tuaja, ndonëse nuk është e thënë të limitoni blerjet, pasi ky është pikërisht muaji për të krijuar idenë se me çfarë po i harxhoni më së shumti paratë tuaja. Në fund të muajit shikoni listën dhe evidentoni produktet apo shërbimet të cilat ju kushtojnë më së shumti. Shikoni rëndësinë që kanë këto shpenzime në jetën tuaj dhe përpikuni të evitoni disa nga këto blerje, sa më shumë të keni mundësi, por pa e ngushtuar veten shumë.

Përpikuni të jeni sa më të drejtë kur bëni një bilanc në letër për shpenzimet tuaja, si dhe mbi vlerën që do shpenzoni, pasi në fund të fundit ato janë paratë tuaja.

Shpenzojini paratë në mënyrë të suksesshme - Shpeshherë blejmë produkte, të cilat i përdorim vetëm njëherë gjatë jetës tonë dhe më pas ju fshijmë vetëm pluhurin. Një mënyrë e mirë për të evituar blerjen e produkteve të tilla është t'i marrim ato me qira. Në këtë formë përveç se shpenzojmë më pak para, na ndihmon të jemi më të kujdesshëm në mirëmbajtjen e produktit. Një tjetër opsion për t'i shpenzuar paratë në mënyrë sa më eficiente është dhe pajisja me një kartë krediti. Nëse nuk keni besim tek vetja dhe mendoni se nuk i rezistoni një karte krediti, mund ta kyçni në dollap, por mjafton të keni një të tillë. Shpeshherë kartat e kreditit janë shumë të rëndësishme për tu stabilizuar, apo për të dalë nga situata.

Bëni investime inteligjente - Përpikuni të njiheni me opsione të ndryshme investimesh. Ndërsa rritemi kuptojmë se bota financiare është shumë më e ndërlikuar se ajo që e kishim menduar. Krijoni përparësi duke çuar një pjesë të parave tuaja në një llogari që mund t'u duhet kur të dilni në pension, shkruan Telegrafi. Nëse e njihni mirë tregun mund të investoni në aksione të ndryshme. Të bësh investime të zgjuara do të thotë që të investosh për veten dhe të ardhmen tënde, ja pse të kesh një mbulim të mirë sigurimi është shumë e rëndësishme. Njerëzit e zgjuar presin të papriturën, në këtë formë ju do të jeni të sigurt përpara çdo të papriture.

Krijoni fond emergjence - Ju duhet të hiqni disa para mënjane, duke pretenduar se nuk i keni, në mënyrë që të krijoni një fond emergjence. Në rastet e emergjencës, paratë të nevojiten menjëherë dhe procedurat nëpër banka kërkojnë pak kohë, qoftë edhe nëse i përmbushni të gjitha kriteret për të marrë një hua. Atëherë zgjidhja më e mirë është të keni këto para mënjane të cilat do t'ju vijnë në ndihmë menjëherë.

REFERENCAT

Blakeslee, R., & Garcia, M. (2002). *Gjuha e Tregtisë*. Vienna: Departamenti i Shtetit SHBA.

Bërxfholi, A. (2008). *Doracak i termave të gjeografisë*. Tiranë: EUGEN.

Bundo, S. (2012). *Financë*. Tiranë: alb PAPER.

Havolli, Y. (2014). *Menaxhmenti i burimeve njerëzore*. Prishtinë: Riinvest.

Mayo, B. H. (2012). *Bazat e Financës*. Tiranë: UET Press.

Skenderi, N. (2010). *Fjlaor Ekonomiko-Social*. Prishtinë: AKB.

<http://www.scan-tv.com/hapat-qe-duhet-te-ndiqni-per-te-menaxhuar-financat-tuaja-personale/>. (n.d.).

<http://www.unifin.al/si-te-menaxhoni-buxhetin-familjar/>. (n.d.).

<https://besimtari.com/ja-6-keshilla-per-menaxhimin-e-parave/>. (n.d.).

<https://iutecredit.al/5-keshilla-per-te-permiresuar-financat-tuaja-personale/>. (n.d.).

<https://sq.atomiyme.com/faqja-ekonomi-menaxhimin-e-financave-personale-si-per-te-kryer-nje-buxhet-ne-shtepi/>. (n.d.).

<https://sq.binaroption.com/stati/353-9-sekretov-upravleniya-lichnymi-finansami>. (n.d.).